



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 022 Prot.

Tiranë, më 07.06 2019

VENDIM Nr. 142, datë 28.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Rikonstrukcion i objektit ekzistues, shtesë volumi anësor dhe shtesë 2 kate, zonë arkeologjike "B" Durrës"*-subjekti Z. Taulant Terpollari, realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Rikonstrukcion i objektit ekzistues, shtesë volumi anësor dhe shtesë 2 kate, zonë arkeologjike "B" Durrës"*-subjekti Z. Taulant Terpollari, realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti Z. Taulant Terpollari të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, punimet e gërmimit do të realizohet nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al